

## **Letër e interesit për vendosjen e një korridorit hekurudhor mes Prishtinës dhe Beogradit**

Duke rikonfirmuar përkushtimin e Republikës së Kosovës për të kontribuar plotësisht në konsolidimin ekonomik, përshejtim të qarkullimit të mallrave, njerëzve dhe shërbimit dhe lidhjes më të afërt të Ballkanit Perëndimor dhe të gjithë qytetarëve që jetojnë në rajon, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit në Kosovë dëshiron të njoftojë dhe të konfirmojë deklaratën në vazhdim në lidhje me vendosjen e korridorit hekurudhor Prishtinë-Beograd.

Rruga do të lidh Prishtinën përmes pikës së kalimit kufitar në Merdare dhe do të lidhet përmes linjave ekzistuese hekurudhore në Nish e pastaj për në korridorin e linjës hekurudhore Alpet-Ballkani Perëndimor.

Rehabilitimi dhe zhvillimi i trafikut hekurudhor që e lidh Prishtinën dhe Beogradin ka rëndësi strategjike, pasi kjo rrugë paraqet lidhjen më të shkurtër me korridorin që lidh me tregjet e Europës Qendrore, Perëndimore dhe Juglindore.

Për qëllimin e vendosjes së trafikut për pasagjerë dhe mallra nëpër rrugën e propozuar Prishtinë-Beograd, duhet të rinovohet dhe ndërtohet infrastrukturë përkatëse që përcillet me zbatim të marrëveshjeve teknike, ligjore dhe profesionale për vendosjen e transportit hekurudhorë për pasagjerë dhe mallra.

Specifikacionet teknike për linjat hekurudhore duhet gjithashtu të jenë në linjë me Standardet Teknike Europiane për Interoperimin (TSI).

Kosova synon të kërkojë mbështetje ndërkombëtare dhe financim që t'i bëjë ndërkombëtare të gjitha rrugët hekurudhore që e lidhin Kosovën me shtetet fqinje.

Duke implementuar këtë iniciativë, provizionet që përbëjnë strukturën ekzistuese ndërkombëtare, do të zbatohen, gjithashtu edhe ato të përcaktuara në marrëveshjet dhe rregullimet të vendosura brenda Bashkimit European.